



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 13.7.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi, Etem Arifi, Salih Morina dhe Daut Haradinaj.

Mungoi : Liburn Aliu,

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media dhe eksperti (Fejzullah Berisha) me zyrtarët e ministrisë së Bujqësisë : Shefki Zeqiri me bashkëpunëtorë.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 11.7.2011;**
3. **Shqyrtimi i projektligjit për Verërat,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.7.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11.7.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Verërat

Kryetari Nait Hasani fillimisht falënderoi pjesëmarrësit në punën e përbashkët rreth projektligjit për verëra, ndërsa në cilësinë e kryesuesit të GP për këtë projektligj pyeti anëtarët e komisionit për ndonjë sugjerim, të cilët nuk kishin, ndaj ju dha fjalën mysafirëve përkatësisht

zyrtarëve të ministrisë dhe ekspertëve prezent. Komisioni kaloi në shqyrtimin e amendamenteve të deritanishme, dhe nxori :

P Ë R F U N D I M

Miratohet Raporti me Amendamente i raportuesit-Kryesuesit të grupit punues Nait Hasani.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.02/L-8 për Verërat me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, si vijon :

Amendamenti 1

Neni 2, pas paragrafit 5 shtohet përkufizimi : **Prodhues familjar**-nënkupton çdo person fizik apo juridik që prodhon për nevoja të veta.

Amendamenti 2

Neni 3 në projektligj, paragrafi 3.5, **nënpika 1.2** në fund pas fjalës “rrushit” vëhet pika dhe vazhdon teksti :

“Vera mund të ruaj emrin e varietetit poçese është e prodhuar prej së paku 85% të rrushit të atij varietetit dhe 15% të varietetit me cilësi përafërsisht të njëjta si vera bazë”.

Pas paragrafit 3.9 shtohet paragrafi 3.10 si vijon :

“Për kategoritë tjera të verës jokulminante, përqindja e përzierjes përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria”.

Amendamenti 3

Pas **Nenit 4** të projektligjit shtohet neni i ri :

Neni 5

Neni 5 të Ligjit, në fund i shtohen dy paragrafë :

5.6. Prodhuesit familjar mund të prodhojnë verë në sasi prej 700 (shtatëqind) litra në vit për konsum vetanak, pa të drejtë tregtimi.

5.7. Prodhuesit e rrushit, mushtit, verës, verërave frutore dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe verëra, duhet të janë të licencuar dhe janë të obliguar të kenë ekspertin.

Amendamenti 4

Neni 9 i projektligjit, në fund shtohet pasusi i dytë si vijon :

Pas paragrafit 16.1 shtohet një paragraf i ri :

16.1 a) Rajoni i vreshtarisë është njësi më e madhe territoriale e vreshtarisë me kushte të ngjashme klimatike dhe tokësore të cilat, të kombinuara me faktorët agrobiologjik ndikojnë në karakteristikat themelore organoleptike të verës së prodhuar në atë rajon. Rajonet e vreshtarisë janë Rajoni i Dukagjinit dhe Rrafshit të Kosovës.

Amendamenti 5

Neni 15 në projektligj në fund i shtohet:

Te neni 25.2 i Ligjit, pika **a) Viti i vjeljes,** fshihet dhe bëhet riradhitja e pikave.

Amendamenti 6

Neni 23 në projektligj, në fillim shtohet teksti si vijon :

Neni 44.2 i Ligjit riformulohet : Eksporti i verës duhet të shoqërohet me certifikatë. Validiteti i certifikatës për analiza fiziko-kimike dhe organoleptike është 3 (tre) muaj, brenda kësaj kohe sasia e mostruar e verës duhet të shitet apo të paketohet.

Lidhur me fjalën “**Institucioni i autorizuar**” tek Neni 20 i Ligjit, Komisioni nxori amendament të ndryshohet, por në ndërkohë stafi konstatoi se Neni 12 i projektligjit e bënë pikërisht këtë ndryshim, ndaj në konsultim me Kryetarin e Komisionit nuk u hartua ky amendament.

Të ndryshme

Në kuadër të çështjeve tjera, komisioni nxori :

R E K O M A N D I M **për mbledhjen plenare**

Të miratohet në parim, Projektligji për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

- Vizita në Komunën e Gjakovës do të realizohet të premtën duke u nisur nga Kuvendi në orën 9,00.

Mbledhja përfundoi në orën 13,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani